

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Hapat që ndërmerren për apelimin e një vendimi të Speciales
ADRESA	https://a2news.com/rajoni-bota/kosova/hapat-qe-ndermerren-per-apelimin-e-nje-vendimi-te-speciales-i1185242
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 06:30:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 06:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2e43dc0992c392273ace43292a22aa93af67abc58098d11dec4a39fe03bb6a89
TEKSTI	bf55b7fea153c0f227a3c2f7c33c06ff020c611d8ac90e58425bf9ca137a8560
PAMJA	adcdbfc70918a914eed1189fa77e435b7c6144dd0a38f47b2a66d7f945496fdf

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9d3d6fd5051ac88f17be3b4073c3c0262b17def0148319341ea18b9fb674706
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7552192d4562aa207666eadcaed525346db194fc39c694c2be0ac3ebbafe5dc8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9d3d6fd5051ac88f17be3b4073c3c0262b17def0148319341ea18b9fb674706>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Hapat që ndërmerren për apelimin e një vendimi të Speciales

Nga A2 CNN
17 Shtator 2026, 08:25 | Kosova



Ekipet mbrojtëse të ish-eporëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë paralajmëruar se do të apelojnë aktgjykimin dënues të shqiptuar nga trupi gjyqësor i Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë më 16 shtator.

Hashim Thaçi u dënua me 25 vjet burgim për katër pika të aktakuzës për krime lufte, Jakup Krasniqi po ashtu u dënua me 25 vjet burgim, ndërkaq Kadri Veseli me 18 dhe Rexhep Selimi me 13 vjet burgim.

Të katër ish-eporët e UÇK-së u shpallën penalisht përgjegjës për krime lufte që përfshijnë ndalimin e paligjshëm ose arbitrar, trajtimin mizor, torturën dhe vrasjen e paligjshme. Gjatë aktgjyimit të shqiptuar në Hagë, trupi gjyqësor hodhi poshtë akuzat e ZPS-së për krime kundër njerëzimit.

Katërshja e UÇK-së gjendet në paraburgim në Hagë që nga nëntori i vitit 2020.

Vendimi i trupit gjyqësor mund të apelohej nga palët e përfshira, nga mbrojtja e cila mund të kërkojë rrëzimin e aktgjyimit në tërësi apo të synojnë uljen e dënimit për pika të caktuara të akuzës, por edhe Zyra e Prokurorit të Specializuar që mund të kërkojë ashpërsim të dënimit.

ZPS-ja mirëpriti vendimin dënues dhe shtoi se do të shqyrtojë të gjithë aktgjykimin, përfshirë edhe rrëzimin e pikave të akuzës që kishin të bënin me krime kundër njerëzimit.

Por, cilat janë procedurat që palët ndjekin për apelim?

Sipas Rregullores së Procedurës dhe Provave, palët që apelojnë vendimin e gjykatës ose dënimit, ose të dyja së bashku, duhet të dorëzojnë atë që quhet njoftimin për apel, ku parashirohen arsyet e apelit, 30 ditë nga shpallja e aktgjyimit.

Më pas, kryegjykatësi i panelit të Gjykatës së Apelit - gjykatë që përbëhet nga tre anëtarë - mund të caktojë një prej gjykatësve si gjykatës raportues për procedurën paraapeluese. Gjykatësi raportues ka për detyrë të marrë masat e nevojshme për aspektet procedurale, sikurse janë lëshimi i vendimeve, urdhrave dhe udhëzimeve me qëllim që të përgatitet çështja për shqyrtim. Ai duhet që rregullisht ta informojë panelin e Gjykatës së Apelit, veçmas nëse ka kontestime lidhur me çështjet procedurale.

Më pas, brenda 21 ditësh nga njoftimi për apel, kryegjykatësi apo gjykatësi raportues e thërret një konferencë ku ngrihen çështje rreth apelit.

Palët që parashirojnë apel duhet të dorëzojnë dosjen e apelit e cila përmban të gjitha argumentet dhe burime të tjera ligjore ku mbështeten arsyet e apelit. Kjo duhet të dorëzohet brenda 60 ditësh apo brenda 30 ditësh nga njoftimi për apel, nëse çështja ka të bëjë vetëm me dënimin e shqiptuar.

TE FUNDIT

“Liria ka emër”, Dua Lipa reagon pas vendimit të Speciales për dënimin e ish-krerëve të UÇK

Laçi: Duhet dialog me ndërkombëtarët, po vijnë situata të egra

“Vendimi për krerët e UÇK-së u mor nga disa gjyqtarë mafiozë”, Nazarko: Nuk është qëndrimi i Perëndimit

Verdikti i Gjykatës Speciale, ekspertja: Problemi erdhi nga Parlamenti i Kosovës

MË TË VIZITUARAT

Robelli: Nuk çojnë askund emocionet dhe mallkimet, duhet krijuar ekip i fuqis...

Dënimi i Thaçit, deputeti Berisha: Kurti nuk ka ndihmuar për çështjen

Dënimi në Hagë, ish-luftëtar i UÇK-së akuza politikanëve të Kosovës: Turp që...

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

Më pas palët dorëzojnë të ashtuquajturën dosje të përgjigjes, ku paraqesin argumentet ligjore të tyre. Afatet se kur dorëzohet kjo dallojnë: 30 ditë për argumentet dhe burimet ligjore dhe 15 ditë vetëm për dënimin nga paraqitja e dosjes. Kjo pasohet me dosjen e kundërpërgjigjes për të cilën afatet janë më të shkurtra, 15 dhe 10 nëse ka të bëjë vetëm me dënimin.

Pas gjithë këtyre afateve, Gjykata e Apelit e cakton datën e një seance "nëse është e nevojshme", thuhet në rregulloren.

Rregullorja parasheh që palët mund të dorëzojnë prova shtesë gjatë procedurës së apelit dhe nëse ato pranohen, pala tjetër mund të paraqesë kundërprova.

Gjatë vendimit, Paneli i Apelit shqyrton çdo provë shtesë të pranuar, por edhe provat që veçse janë pjesë e dokumentacionit.

Sapo të përfundojnë parashtrimet nga palët, paneli i Apelit mbledhet dhe shqyrton çështjen dhe nxjerr aktgjykim për dokumentacionin e apelit dhe për çdo provë shtesë të pranuar.

Pra, Gjykata e Apelit mund të lërë në fuqi, të zhbëjë ose të ndryshojë aktgjykimin e trupit gjykues apo të mbahet rigjykim.

Megjithatë, nëse kërkesa për apel bëhet vetëm nga personat e shpallur fajtorë, Gjykata e Apelit nuk mund të shqiptojë vendim më të rëndë se shkalla e parë.

Vendimi i apelit shqiptohet brenda 60 ditësh nga parashtrimi i fundit i palëve. Megjithatë, edhe për këtë mund të kërkohet kohë shtesë, por jo më shumë se një muaji dhe zgjatja e afatit duhet të arsyetohet.

Sipas Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar janë tri arsye për të cilat mund të dorëzohen apele për vendime të shkallës së parë: ndonjë gabim rreth ndonjë çështje juridike që e shfuqizon aktgjykimin, ndonjë gabim faktik i cili ka shkaktuar dështimin e drejtësisë ose ndonjë gabim për sa i përket dhënies së dënimit.

Nëse palët nuk janë të kënaqura me vendimin e Apelit, çështja mund të dërgohet në Gjykatën Supreme dhe më pas në atë Kushtetuese të Dhomave të Specializuara në Hagë.

Mbrojtësit e ish-presidentit, Hashim Thaçi, thanë se procesi i apelit mund të marrë vite kohë.

Vendimi i trupit gjykues

Pas 41 muajsh të nisjes së gjykimin, trupi gjykues gjeti fajtorë katër ish-eprorët e UÇK-së për krime lufte, por rrëzoi akuzat për krime kundër njerëzimit.

Sipas trupit gjykues, katërshja e UÇK-së, së bashku me udhëheqës të tjerë, kishin për qëllim pavarësinë e Kosovës dhe vendosjen e kontrollit politik e institucional mbi një Kosovë të pavarur.

Sipas gjykatës, për realizimin e këtyre objektivave, ata kishin një qëndrim të përbashkët se disa persona që konsideroheshin pengesë për qëllimet e tyre duhej të "shënjestroheshin", "eliminoheshin" ose "neutralizoheshin".

Këta persona thuhet se përfshinin, ndër të tjera, anëtarë ose përfaqësues të forcave të tjera politike dhe ushtarake, veçanërisht persona të lidhur me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK), persona që konsideroheshin të lidhur me autoritetet serbe, si dhe pjesëtarë të komuniteteve romë dhe serbe.

Gjatë shpalljes së aktgjykimin, trupi gjykues tha se ky qëllim i përbashkët ishte zbatuar përmes vrasjeve, arrestimeve dhe ndalimeve pa proces të rregullt ligjor, si dhe keqtrajtimin fizik e psikologjik, frikësimit dhe përdorimit të asaj që në aktgjykim quhet "luftë speciale".

Trupi gjykues tha se ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarët Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli dhe ish-deputeti Rexhep Selimi, kontribuan në zbatimin e këtij qëllimi të përbashkët.

Në rastin e Thaçit, trupi gjykues tha se ai kishte luajtur rol kyç në formulimin dhe zbatimin e qëllimit të përbashkët, teksa konstatoi se kishte marrë pjesë edhe personalisht në disa prej krimeve, duke përmendur rastin e Behajdin Allaqit.

Për Veselin, Gjykata Speciale përmendi pozitën e tij si shef i Drejtorisë së Zbulimit të UÇK-së, organ që, sipas konstatimeve të trupit gjykues, kishte përgjegjësi për identifikimin, vëzhgimin dhe neutralizimin e personave të dyshuar si "kolaboracionistë". Dhomat e Specializuara thanë se ai nuk ndërmori hapa për parandalimin, hetimin ose ndëshkimin e krimeve, megjithëse kishte dijeni për to.

Për Selimin, trupi gjykues konstatoi se ai kishte kontribut të qenësishëm në zbatimin e qëllimit të përbashkët. Gjykata theksoi se pozita e tij si inspektor i Përgjithshëm i UÇK-së i jepte më pak pushtet mbi anëtarët e tjerë të UÇK-së, krahasuar me disa prej të akuzuarve të tjerë.

Ndërsa për Krasniqin, që në kohë të luftës kishte qenë zëdhënës i UÇK-së dhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, gjykata konstatoi se ai kishte përdorur pozitën, rolin si udhëheqës, pushtetin dhe statusin e tij për zbatimin e aspekteve kriminale të qëllimit të përbashkët.

/REL/ (A2 Televizion)

A2 CNN **Livestream**

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



“Drejtësi e papranueshme”, Kurti: Nuk mund të dënohet arsyeja pse lindi UÇK-ja e as të njolloset ajo



“Dënimi, shkund themelet e Kosovës”, e gjithë UÇK në Hagë: Besojmë në lirimin e bashkëluftëtarëve



Vendimi historik për çlirimtarët, gjyqtarët që kanë në dorë fatin e Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit



Votime, grindje dhe krizë pa fund, Kuvendi vijon të dielën, PDK heq dorë dhe pret Kushtetuesen





Reagon OVL e UÇK: Nuk fshihet dot
dështimi i një prokurorie të njëanshme!



"Prokuroria nuk është e qartë", Avokatja:
ZVP nuk ka provë për ndërhyrjen e Thaçit


Latest Videos



"Ditë e zezë për Kosovën", preket deputetja e PDK-së: Nesër
në Kuvend do të merren masa serioze



"Krerët e UÇK-së do të lirohen në apel", deputeti AAK: Nuk
mund të shlyhet damka që na kanë lënë sot



"Shumë e ulët", ish-luftëtari i UÇK-së shpërthen ndaj
politikanëve të Kosovës: Turp që po përdorni



"Sot na damkosën lirinë", deputeti i AAK-së tregon planin
për të shfuqizuar Gjykatën Speciale

Shqipëria

Aktualitet
Kronikë
Politikë
Ekonomi
Sociale
Kulturë
Moti

Kosova

Kulturë
Sociale
Ekonomi
Politikë
Kronikë
Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani
Bota

Argëtim

Showbiz
Lifestyle
Kapur në kamera
Teknologji

Sport

Live Euro 2024
Futboll
Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta
A2 CNN në Izrael
31 Minuta
A2 CNN në Ukrainë
Lumi i kokainës
Ditari ndërkombëtar
Zbulo
Imagjinatë
Dëshmi



Live TV

Rreth nesh Kushtet e Privatësisë Karriera Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësuar nga Mediaset

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.